


PASAPORTA E TREGUESVE
Strategjia ndërsektoriale kundër korrupsionit
2015-2020



SHQIPËRIA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË



This project is funded
by the European Union

Disclaimer:

This report has been prepared with the financial assistance of the European Commission. The views expressed herein are those of the consultants and therefore in no way reflect the official opinion of the Commission.

Korrupsioni në Shqipëri është mjaft i përhapur dhe pavarësisht përpjekjeve për ta frenuar atë, rezultatet e shtetit nuk kanë qenë edhe aq efektive. Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, Shqipëria ka rritur përpjekjet kundër korrupsionit duke miratuar strategji ndër-sektoriale të tërthorta. Fillimisht u miratua një Strategji Ndër-sektoriale për Parandalimin dhe Luftën kundër Korrupsionit dhe Qeverisjen Transparente 2008-2013, e cila u pasua nga Strategjia Ndër-sektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020. Në këtë strategji janë përcaktuar një sërë Treguesish të Përgjithshëm dhe Objektiva Specifike që konsistojnë në një qasje të trefishtë: parandalimi, shtypja dhe sensibilizimi. Një Plan Veprimi që konsiston në 191 masa (143 parandalime, 26 shtypje, 22 sensibilizime) u miratua dhe u zbatua përgjatë periudhës 2015-2017. Megjithatë, në aspektin e monitorimit të rezultateve, Strategjia dhe Plani përkatës i Veprimit nuk kishin tregues të detajuar të performancës për të matur arritjen e objektivave specifike.

Krahasimisht, ky dokument ofron një Pasaportë të Treguesve për të gjitha 18 Objektivat Specifike, me shifra të qarta për çdo tregues bazë dhe objektivat përkatëse. Pasaporta ka për qëllim të shndërrohet në instrumentin kryesor të monitorimit për t'u

përdorur nga Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit (KKK), administrata publike dhe politikë-bërësit për të matur zbatimin dhe efektivitetin e Strategjisë. Pasaporta përfshin 38 tregues të performancës, kryesisht tregues sasiore, të zhvilluar për të matur progresin e secilës prej 18 Objektivave Specifike të Strategjisë Ndër-sektoriale kundër korrupsionit 2015-2020.

Çdo tregues përfshin:

- një përshkrim të treguesit,
- lidhjen me objektivin specifik të strategjisë,
- institucionin përgjegjës për të dhënat,
- burimin e të dhënave për monitorimin e treguesve,
- frekuencën e matjes së të dhënave si një mjet verifikimi për monitorimin e treguesit,
- një metodologji të shkurtër për llogaritjen e treguesit;
- vlerën bazë që pasqyron situatën në tre vitet e mëparshme (2015, 2016 dhe 2017)⁴
- performancën e synuar për t'u realizuar në 3 vitet e ardhshme (2018, 2019 dhe 2020).

Pasaporta e Treguesve do të përdoret si fillim si mjet për hartimin e një Plani të Veprimit dhe në hapat e mëtejshme për të ndihmuar KKK-në për të monitoruar dhe zbatuar Strategjinë Ndër-sektoriale kundër korrupsionit 2015-2020 dhe së fundi, për qeverinë shqiptare për të vlerësuar progresin e bërë në arritjen e objektivave specifike të përshkuara nga Strategjia.

Përmbajtja

A.1.a	Numri i institucioneve që kanë zbatuar saktë programet e transparencës	6
A.1.b	Regjistri qendror për kërkesat dhe përgjigjet do të jetë funksional deri në vitin 2020	7
A.2.a	Raporti i elementeve të ndryshuar në Planet Vjetore të Prokurimit	8
A.2.b	Pjesa e kontratave të dhëna përmes procedurave me negociim pa publikuar paraprakisht njoftimin e kontratës	9
A.2.c	Pjesa e kontratave të ndryshuara gjatë vitit	10
A.3	Numri i shërbimeve elektronike funksionale për qytetarët, bizneset dhe institucionet publike	11
A.4	Numri i hetimeve për korrupsion sipas denoncimeve të qytetarëve	12
A.5.a	Sistemi online për deklarimin e pasurive do të jetë funksional në vitin 2020	14
A.5.b	Zbatimi i ligjit për Sinjalizimin dhe mbrojtja e Sinjalizuesve	16
A.6.a	Numri i raporteve të publikuara të auditimit nga partitë politike të certifikuara nga auditorët e jashtëm	17
A.6.b	Raporti i sanksioneve të dhëna për rastet e identifikuara në kontekstin e shkeljeve të Kodit Zgjedhor	18
A.6.c	Financat e partive politike të audituara në përputhje me rekomandimet e BE/ACFA	19
A.7.a	Raporti i rekomandimeve të auditimit të brendshëm të pranuar dhe zbatuara nga subjektet publike	20
A.7.b	Numri i rasteve që vijnë nga auditime të brendshme që raportohen për hetim financiar	22
A.7.c	Numri i referimeve në prokurori si pasojë e inspektimeve financiare	23
A.7.d	Numri i inspektimeve financiare të kryera nga Njësia e Inspektimit Financiar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë	24
A.8	Numri i institucioneve publike që kanë kryer analiza vjetore për prirjet për korrupsion	25
A.9	Numri i ministrive që kanë zhvilluar dhe publikuar një plan integriteti në përputhje me strategjinë ndër-sektoriale kundër korrupsionit	27
A.10	Statistika të konsoliduara dhe të harmonizuara për korrupsionin prodhohen dhe publikohen në mënyrë periodike.	28
A.11.a	Raporti i bashkive që kanë hartuar plane vendore anti-korrupsion dhe plane integriteti (në përputhje me strategjinë ndër-sektoriale kundër korrupsionit)	30
A.11.b	Numri i Bashkive që alokojnë një zë të veçantë të buxhetit për zbatimin e politikës vendore anti-korrupsion	32
B.1.a	Numri i kallëzimeve për korrupsion (rastet dhe personat)	33
B.1.b	Numri i kërkesave për sekuestrimin e pasurive në rastet e korrupsionit	35
B.1.c	Vlera e parashikuar e të ardhurave nga krimi të sekuestruara në rastet e korrupsionit	37
B.2.a	Raporti i procedurave të regjistruara mbi korrupsionin nga referimet e administruara	39
B.2.b	Numri i aksesit në bazat e të dhënave shtesë për policinë dhe prokurorinë	40
B.3.a	Numri i raporteve të rishikimit të hartuara në mënyrë periodike dhe të bëra publike nga Ministria e Drejtësisë mbi përshtatshmërinë e kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimeve ekonomike dhe financiare	41
B.3.b	Zbatimi i legjislacionit për ngritjen e një Zyre të Rikuperimit të Pasurive	43
B.4.a	Numri i informacioneve të Policisë i shkëmbyer me vendet e treta dhe institucionet mbi-kombëtare mbikëqyrëse të zbatimit të ligjit	45
B.4.b	Numri i operacioneve të përbashkëta të Policisë të nisura nga Europol ose Interpol në fushën e luftës kundër krimit financiar dhe ekonomik ku Shqipëria merr pjesë aktivisht	46
C.1.a	Krijimi i planeve vjetore të komunikimit dhe vizibilitetit të Strategjisë Kundër Korrupsionit	47
C.1.b	Numri i fushatave vjetore të ndërgjegjësimit për luftën kundër korrupsionit	48
C.2.a	Numri i denoncimeve të qytetarëve për korrupsion të denoncuar në platformën www.shqiperiaqeduam.al	49
C.2.b	Numri i rasteve të korrupsionit të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve në www.shqiperiaqeduam.al , të cilat i raportohen Policisë së Shtetit/Prokurorisë Shqiptare	50
C.3.a	Hartimi i një Programi Anti-korrupsion nga AMSHC-ja	51
C.3.b	Raporti i projekteve të anti-korrupsionit të financuar nga ASCS	52
C.3.c	Alokimi i buxhetit në mbështetje të Projekteve të Anti-korrupsionit nga OSHC-të	53

Objektivi A1

Rritja e transparencës në veprimtarinë shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion

A.1.a Numri i institucioneve që kanë zbatuar saktë programet e transparencës

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës

- Raportet e monitorimit të botuara dy herë në vit nga IDP-ja
- Raporti vjetor i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Frekuenca e publikimit të të dhënave

Dy herë në vit

Përshkrim i shkurtër i metodologjisë

Zyra e Komisionerit monitoron dy herë në vit programet e transparencës së institucioneve dhe publikon një raport. Stafi i IDP-së monitoron nëse institucionet kanë publikuar të gjitha llojet e informacionit që parashikohen në nenin 7 të Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit” si për shembull buxheti, prokurimi, struktura, kuadri ligjor, etj. IDP-ja gjithashtu monitoron nëse koordinatori ka përditësuar regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve.

Performanca vlerësohet duke matur rritjen në % të numrit total të institucioneve që kanë zbatuar si duhet programet e transparencës, krahasuar me vitin e mëparshëm.

Informacioni për vlerat bazë	Viti	2015	2016	2017
	Vlera bazë ¹		108	154

Informacioni për vlerat e synuara	Viti	2018	2019	2020
	Vlera e synuar		20% rritje krahasuar me vitin e mëparshëm	30% rritje krahasuar me vitin e mëparshëm

¹ Vlerat bazë për të gjithë Treguesit e Pasaportës janë grumbulluar gjatë periudhës Shkurt-Prill 2018, në bazë të të dhënave të dërguara nga institucionet raportuese. Ekipi nuk ka mundur të kryejë kontrolle të tërthorta për të gjitha burimet e të dhënave, pasi në disa raste burimi i të dhënave nuk është publik dhe/ose nuk ekziston një raportim i brendshëm i konsoliduar për këto të dhëna.

Objektivi A1

Rritja e transparencës në veprimtarinë shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion

A.1.b Regjistri qendror për kërkesat dhe përgjigjet do të jetë funksional deri në vitin 2020

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës Raporti vjetor i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Frekuenca e publikimit të të dhënave Çdo vit (përpunim i të dhënave në baza ditore - përpilohen raporte të ndërmjetme nëse duhet)

Përshkrim i shkurtër i metodologjisë Zyra e Komisionerit ka ndërtuar një regjistër qendror për kërkesat dhe përgjigjet, me qëllim harmonizimin e mbledhjes dhe përpunimit të ankesave. Ky proces është me rëndësi për sigurimin e një pune efektive nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike ndaj qytetarëve dhe OJF-ve.

Treguesi do të vlerësohet duke matur së pari krijimin e Regjistrit (procesi) dhe më pas funksionimin e tij (performanca).

Informacioni për vlerat bazë	Viti	2015	2016	2017
	Vlera bazë	-	-	-
Informacioni për vlerat e synuara	Viti	2018	2019	2020
	Vlera e synuar (procesi)	Krijimi i regjistrit qendror dhe miratimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave, duke e bërë të detyrueshëm përdorimin e këtij regjistri		
Vlera e synuar (performanca)		30 institucione përdorin këtë sistem për të raportuar (d.m.th të gjithë Ministrinë dhe institucionet e pavarura)	80% institucione të tjera përdorin këtë sistem për të raportuar, krahasuar me të dhënat e vitit 2019	

Objektivi A2

Rritja e transparencës në planifikimin, detajimin, menaxhimin dhe kontrollin e fondeve buxhetore

A.2.a Raporti i elementeve të ndryshuar në Planet Vjetore të Prokurimit

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Sistemi Elektronik i Prokurimit/ Raporti Vjetor i APP-së
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Agjencia e Prokurimit Publik
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Çdo vit
Përshkrim i shkurtër i metodologjisë	Planet e Prokurimit të hartuara nga autoritetet kontraktore përbëhen nga disa elementë. Përqindja e elementeve të ndryshuara gjatë vitit reflekton saktësinë e autoriteteve Kontraktore në planifikimin e prokurimit. Publikimi online i planeve të prokurimit filloi në vitin 2018.

Një planifikim më i mirë do të ndikojë pozitivisht në uljen e rrezikut të korrupsionit (d.m.th. duke kufizuar mundësitë për negociata jo-transparente dhe ndryshime të zërave të buxhetit).

Performanca do të vlerësohet duke matur raportin mes numrit total të elementeve të ndryshuara dhe numrit total të elementëve të publikuar në planet vjetore të prokurimit. Formula specifike e përdorur për treguesin do të jetë:

$$E_{\text{mod.}} = \frac{\sum \text{e numrit të elementeve të ndryshuar}}{\sum \text{e numrit të elementeve të publikuar në planin vjetor}} \times 100\%$$

Informacioni për vlerat bazë	Viti	2015	2016	2017
	Vlera bazë		-	-
Informacioni për vlerat e synuara	Viti	2018	2019	2020
	Vlera e synuar	50%	35%	20%

² Metodatat aktuale të llogaritjes që përdoren nga institucioni nuk lejojnë identifikimin e pikënisjes për vitin 2017. Një sistem i ri online është funksional nga Janari i vitit 2018.

Objektivi A2

Rritja e transparencës në planifikimin, detajimin, menaxhimin dhe kontrollin e fondeve buxhetore

A.2.b Pjesa e kontratave të dhëna përmes procedurave me negociim pa publikuar paraprakisht njoftimin e kontratës

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Sistemi Elektronik i Prokurimit/ Raporti Vjetor i APP-së
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Agjencia e Prokurimit Publik
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Çdo vit
Përshkrim i shkurtër i metodologjisë	<p>Gjatë viteve të fundit, numri i procedurave me negociim pa publikuar paraprakisht njoftimin e kontratës në Shqipëri ka qenë relativisht i lartë krahasuar me numrin total të procedurave të dhëna (elektronike plus procedurat me negociim pa publikim paraprak), duke shënuar nivelet 30-32%.</p> <p>APP-ja ka marrë tashmë disa masa për përmirësimin e situatës dhe uljen e numrit të këtyre procedurave, të cilat pritet të japin rezultat në fund të vitit 2018. Ky tregues përdoret nga APP-ja për raportimin e Buxhetit</p> <p>Performanca do të vlerësohet duke matur raportin e numrit total të procedurave me negociim të dhëna pa publikim paraprak të njoftimit të kontratës krahasuar me numrin total të procedurave të dhëna (elektronike + me negociim pa publikim paraprak). Formula specifike e përdorur për treguesin do të jetë:</p> $N_{\text{proc.}} = \frac{\sum \text{e numrit të procedurave të negociuara të dhëna pa publikim paraprak të njoftimit të kontratës}}{\sum \text{e numrit të procedurave të dhëna (elektronike + procedura të negociuara pa publikim paraprak të njoftimit)}} \times 100\%$

Informacioni për vlerat bazë	Viti	2015	2016	2017
	Vlera bazë	-	-	31.8 %
Informacioni për vlerat e synuara	Viti	2018	2019	2020
	Vlera e synuar	Më pak se 20%	Më pak se 15%	Më pak se 10%

SHËNIM: Ky Tregues është Treguesi i Disbursimit numër 5 i “Kontratës së reformës së Sektorit të BE-së për luftën kundër korrupsionit në Shqipëri” 2017-2020

Objektivi A2

Rritja e transparencës në planifikimin, detajimin, menaxhimin dhe kontrollin e fondeve buxhetore

A.2.c Pjesa e kontratave të ndryshuara gjatë vitit

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës Sistemi Elektronik i Prokurimit/ Raporti Vjetor i APP-së

Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave Agjencia e Prokurimit Publik

Frekuenca e publikimit të të dhënave Çdo vit

Përshkrim i shkurtër i metodologjisë Numri i lartë i kontratave të ndryshuara gjatë vitit thekson mangësitë e Autoritetit Kontraktor në planifikimin e procedurave dhe hartimin e specifikimeve teknike, si dhe në zbatimin e kontratës. Kjo mund të lidhet gjithashtu me praktikën korruptive.

Ulja e numrit të kontratave të ndryshuara gjatë vitit tregon një shenjë të qartë të rritjes së transparencës në planifikimin, shtjellimin, administrimin dhe kontrollin e buxheteve.

Performanca do të vlerësohet duke matur raportin mes numrit total të kontratave të ndryshuara krahasuar me numrin total të kontratave. Formula specifike e përdorur për treguesin do të jetë:

$$C_{\text{ame.}} = \frac{\sum \text{e numrit të kontratave të ndryshuara}}{\sum \text{e numrit të kontratave}} \times 100\%$$

Informacioni për vlerat bazë	Viti	2015	2016	2017
	Vlera bazë		-	-

Informacioni për vlerat e synuara	Viti	2018	2019	2020
	Vlera e synuar		20%	15%

A.3 Numri i shërbimeve elektronike funksionale për qytetarët, bizneset dhe institucionet publike

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Raportet e AKSHI-t për numrin e shërbimeve elektronike të disponueshme në portalin e-Albania		
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit		
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Çdo vit		
Përshkrim i shkurtër i metodologjisë	<p>Nr. i shërbimeve elektronike për nivelet 3 & 4 të verifikimit bazohet në katër hapat e OKB-së për zhvillimin e shërbimeve online, sipas përkufizimit të mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Hapi 3 - Shërbimet e transaksioneve Faqet e internetit të qeverisë kryejnë një komunikim dy-kahesh me qytetarët e saj, përfshirë këtu dërgimin e kërkesave dhe marrjen e të dhënave për politikën, programet dhe rregulloret e qeverisë, etj. Për të kryer në mënyrë të suksesshme këtë shkëmbim nevojitet një lloj vërtetimi elektronik për identitetin e qytetarëve. Faqet e internetit të qeverisë përpunojnë transaksione jo-financiare, p.sh. deklarimi online i taksave ose aplikimi për certifikata, licenca dhe leje. Ata gjithashtu trajtojnë transaksione financiare, d.m.th. kur paratë transferohen në një rrjet të sigurt. • Hapi 4 - Shërbimet e lidhura Faqet e internetit të qeverisë kanë ndryshuar mënyrën se si qeveritë komunikojnë me qytetarët e tyre. Ata janë proaktive në kërkimin e informacioneve dhe opinionëve nga qytetarët, duke përdorur Web 2.0 dhe instrumente të tjera interaktive. Shërbimet elektronike dhe zgjidhjet elektronike prekin tërthorazi departamentet dhe ministritë në mënyrë të vazhdueshme. Informacioni, të dhënat dhe njohuritë përcillen nga agjencitë qeveritare nëpërmjet aplikacioneve të integruara. Qeveritë kanë kaluar nga një qasje e përqendruar te vetë qeveria, drejt një qasje të përqendruar te qytetarët, ku shërbimet elektronike synojnë qytetarët nëpërmjet ngjarjeve të ciklit të jetës dhe grupeve të ndara për të garantuar shërbime të posaçme. Qeveritë krijojnë një mjedis që i fuqizon qytetarët, duke i përfshirë më shumë në aktivitetet e qeverisë dhe duke pasur zërin e tyre në vendim-marrje. <p>Performanca do të vlerësohet duke matur rritjen e numrit total të shërbimeve elektronike të disponueshme për qytetarët, bizneset dhe institucionet publike.</p>		

Informacioni për vlerat bazë	Viti	2015	2016	2017
	Vlera bazë		248	465

Informacioni për vlerat e synuara	Viti	2018	2019	2020
	Vlera e synuar		562	582

A.4 Numri i hetimeve për korrupsion sipas denoncimeve të qytetarëve

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesve të performancës Raporti vjetor për strukturën e hetimit për korrupsion në Policinë e Shtetit - burimet e të dhënave përfshijnë:

- Ankesat e qytetarëve në portalet qeveritare anti-korrupsion
- Ankesat e qytetarëve përmes postës elektronike dhe asaj të shkruar

Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave Policia e Shtetit

Frekuenca e publikimit të të dhënave Çdo vit

Përshkrim i shkurtër i metodologjisë Që nga viti 2017, të dhënat e disponueshme nga Policia e Shtetit tregojnë numrin total të hetimeve dhe numrin total të hetimeve të gjeneruara me iniciativë të Policisë. Diferenca ndërmjet këtyre shifrave përfaqëson numrin total të hetimeve të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve dhe nga institucione të tjera. Plani i Veprimit duhet të ketë si prioritet një aktivitet për krijimin e një sistemi për ndjekjen e numrit të hetimeve të gjeneruara veçanërisht nga denoncimet e qytetarëve. Sapo të vendoset ky sistem, Plani i Veprimit duhet të ketë si prioritet vendosjen e % matëse statistikore të këtyre hetimeve, të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve të dërguara nëpërmjet portaleve online.

Në këtë fazë, baza është e disponueshme vetëm për totalin e numrit të hetimeve të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve dhe të institucioneve të tjera.

Treguesi do të vlerësohet duke matur së pari përmirësimin e procesit të monitorimit të brendshëm të Policisë së Shtetit në mënyrë që të merren të dhëna të ndara (procesi) dhe më pas rritjen e numrit total të hetimeve të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve (performanca).

Për vitin 2019 dhe 2020 është vendosur një nën-tregues shtesë për të matur përqindjen e hetimeve të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve të dërguara nëpërmjet portaleve online.

· Nën-treguesi A.4.a.1: Raporti i hetimeve të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve, të cilat janë dërguar nëpërmjet portaleve online, krahasuar me numrin total të hetimeve të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve;

$$R_{Acc.} = \frac{\sum \text{e numrit të hetimeve nga denoncimet e qytetarëve të dërguara nga portalet online}}{\sum (\text{Numri i hetimeve nga denoncimet e qytetarëve})} \times 100\%$$

Objektivi A4 Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit

A.4 Numri i hetimeve për korrupsion sipas denoncimeve të qytetarëve

Informacioni për vlerat bazë	Viti	2015	2016	2017
	Vlera bazë	-	615 (numri total, qytetarë dhe institucione të tjera)	678 (numri total, qytetarë dhe institucione të tjera)
Informacioni për vlerat e synuara	Viti	2018	2019	2020
	Vlera e synuar (procesi)	Përmirësimi i procesit të monitorimit të brendshëm të Policisë së Shtetit me qëllim marrjen e të dhënave të ndara	-	-
	Vlera e synuar (performanca)	-	5% rritje krahasuar me vitin 2018	5% rritje krahasuar me vitin 2019

Objektivi A5

Forcimi i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave

A.5.a Sistemi online për deklarimin e pasurive do të jetë funksional në vitin 2020

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës Raporti vjetor i ILDKPKI-së

Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave ILDKPKI

Frekuenca e publikimit të të dhënave Çdo vit

Përshkrim i shkurtër i metodologjisë

Vendosja plotësisht në funksion e sistemit online për deklarimin e pasurive përbën një hap themelor në forcimin e regjimit të deklarimit, transparencës dhe kontrollit efektiv të pasurisë së nëpunësve publikë, si edhe të rasteve të konfliktit të interesit.

Vendosja plotësisht në funksion është një punë sfiduese që duhet të kryhet duke ndjekur disa hapa, veçanërisht sa më poshtë:

- Plotësimi i procedurave të prokurimit dhe nënshkrimi i kontratës
- Projektimi i sistemit dhe përgatitja e dokumentacionit
- Zhvillimi i sistemit dhe ngritja e infrastrukturës
- Përfundimi i zbatimit, vizualizimit/funksionimit të sistemit, instalimi i bazës së të dhënave dhe ndërtimi i aplikacionit
- Zgjidhja e problemeve dhe rikodimi/ritestimi
- Testimi i integruar dhe dorëzimi
- Pajisja me materialet e trajnimit dhe me përdoruesit e trajnimit
- Pranimi përfundimtar dhe vendosja në funksionim të plotë e sistemit (live)

Treguesi do të vlerësohet duke matur plotësimin e hapave të ndërmjetëm për ta bërë sistemin online për deklarimin e pasurive plotësisht funksional (procesi) dhe, në vitin 2020, duke matur përdorimin efektiv të tij (performanca).

Objektivi A5

Forcimi i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave

A.5.a Sistemi online për deklarimin e pasurive do të jetë funksional në vitin 2020

Informacioni për vlerat bazë	Viti	2015	2016	2017
	Vlera bazë	-	-	-
Informacioni për vlerat e synuara	Viti	2018	2019	2020
	Vlera e synuar (procesi)	Plotësimi i procedurave të prokurimit dhe nënshkrimi i kontratës. Projektimi i sistemit dhe përgatitja e dokumentacionit Zhvillimi i sistemit dhe ngritja e infrastrukturës	Përfundimi i zbatimit, vizualizimit/funksionimit të sistemit, instalimi i bazës së të dhënave dhe ndërtimi i aplikacionit Zgjidhja e problemeve dhe rikodimi/ritestimi Testimi i integruar dhe dorëzimi Pajisja me materialet e trajnimit dhe me përdoruesit e trajnimit Pranimi përfundimtar dhe vendosja në funksionim të plotë e sistemit (live)	-
	Vlera e synuar (performanca)	-	-	80% e individëve që raportojnë deklarojnë online pasuritë e tyre

Objektivi A5

Forcimi i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave

A.5.b Zbatimi i ligjit për Sinjalizimin dhe mbrojtja e Sinjalizuesve

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesve të performancës	Raporti vjetor i ILDKPKI-së
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	ILDKPKI
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Çdo vit
Përshkrim i shkurtër i metodologjisë	Në qershor të vitit 2016, u miratua ligji për Sinjalizimin dhe mbrojtjen e Sinjalizuesve (Nr. 60/2016) i cili hyri në fuqi që nga data 1 tetor 2016, me përjashtim të detyrimeve të përcaktuara në nenin 10, të cilat hynë në fuqi me 1 qershor 2017. Në Shqipëri, duhet të dërgojnë raporte 31 institucione qendrore publike dhe 60 njësi të qeverisjes vendore me më shumë se 80 punonjës ³ . Kohëzgjatja e procedurës administrative të hetimit, sipas nenit 13 të ligjit, është përcaktuar 60 ditë. Neni 22 i ligjit prezanton detyrimet e raportimit.

Performanca do të vlerësohet duke matur raportin mes numrit total të deklarimeve të raportuara të sinjalizuesve të iniciuara nga jashtë dhe të plotësuara brenda afatit ligjor krahasuar me numrin total të deklarimeve të raportuara të sinjalizuesve të iniciuara nga jashtë. Formula specifike e përdorur për treguesin do të jetë:

$$W_{rep.} = \frac{\sum \text{e numrit të sinjalizimeve të nisura të raportuara të jashtme të përfunduara brenda afatit ligjor}}{\sum \text{e numrit total të sinjalizimeve të nisura të raportuara të jashtme}} \times 100\%$$

Informacioni për vlerat bazë	Viti	2015	2016	2017
	Vlera bazë	-	-	161 institucione dorëzuan raportet tek ILDKPKI në janar 2018
Informacioni për vlerat e synuara	Viti	2018	2019	2020
	Vlera e synuar	70%	80%	85%

SHËNIM: Ky Tregues është Treguesi i Disbursimit numër 1 i “Kontratës së reformës së Sektorit të BE-së për luftën kundër korrupsionit në Shqipëri” 2017-2020

³ Që nga janari i vitit 2018, ILDKPKI-ja ka marrë dhe administruar 161 raporte vjetore nga njësitë përgjegjëse të sektorit publik. Ndërkohë që njësitë përgjegjëse në sektorin privat do t'i dërgojnë raportet e tyre vjetore që nga janari i vitit 2019.

A.6.a Numri i raporteve të publikuara të auditimit nga partitë politike të certifikuara nga auditorët e jashtëm

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës Raporti financiar i partive politike, raporti i monitorimit, raporti i auditimit i publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Frekuenca e publikimit të të dhënave Çdo vit

Përshkrim i shkurtër i metodologjisë Sipas legjislacionit (duke përfshirë Kodin Zgjedhor dhe Ligjin për Partitë Politike) të gjitha informacionet e mbledhura nga KQZ (p.sh. raportet financiare, raportet e monitorimit dhe auditimit) administrohen me qëllim arritjen e transparencës, kontrollit dhe mbikëqyrjes.

Regjimi kontrollues për financimin e partive politike kërkon para së gjithash përfundimin e raporteve të auditimit të jashtëm mbi financimet e marra nga secila parti politike. Ky vlerësim i jashtëm i nivelit të parë do të forcojë rolin kontrollues efektiv të KQZ-së dhe besueshmërinë e analizës së nivelit të dytë të kryer nga institucioni.

Performanca do të vlerësohet duke matur rritjen në% të raporteve të auditimit nga partitë politike të cilat janë të certifikuara nga auditorët e jashtëm dhe të pranuar nga KQZ-ja. Formula specifike e përdorur për treguesin do të jetë:

$$A_{\text{cert.}} = \frac{\sum \text{e numrit të raporteve të auditimit të partive politike të certifikuara nga auditorë të jashtëm}}{\sum \text{e numrit të raporteve të auditimit nga partitë politike}} \times 100\%$$

Informacioni për vlerat bazë	Viti	2015	2016	2017
	Vlera bazë		88% (77 nga 87)	48% (61 nga 126)
Informacioni për vlerat e synuara	Viti	2018	2019	2020
	Vlera e synuar	70%	75%	80%

A.6.b Raporti i sanksioneve të dhëna për rastet e identifikuara në kontekstin e shkeljeve të Kodit Zgjedhor

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës Raporti Vjetor i KQZ-së - burimet specifike të të dhënave përfshijnë vendimet e KQZ-së “për vendosjen e sanksioneve administrative”

Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Frekuenca e publikimit të të dhënave Çdo vit (për vitet jo-zgjedhore) dhe një herë në dy vjet (për vitet e zgjedhjeve)

Përshkrim i shkurtër i metodologjisë Ndikimi efektiv operacional i regjimit kontrollues mund të vlerësohet duke matur verifikimin e shkeljeve të konstatuara dhe sanksioneve përkatëse të vendosura për çdo shkelje, në përputhje me Kodin Zgjedhor.

Performanca do të vlerësohet duke matur rritjen në % të sanksioneve të dhëna për rastet e identifikuara. Formula specifike e përdorur për treguesin do të jetë:

$$R_{\text{san.}} = \frac{\sum \text{e numrit të sanksioneve të dhëna}}{\sum \text{e numrit të shkeljeve të identifikuara}} \times 100\%$$

Informacioni për vlerat bazë	Viti	2015	2016	2017
	Vlera bazë		10%	0 ⁴
Informacioni për vlerat e synuara	Viti	2018	2019	2020
	Vlera e synuar	25% ⁵	25%	30%

⁴ Nuk ka sanksione të dhëna

⁵ Subjekti raportues (KQZ) komunikoi se objektivat për vitet 2018, 2019 dhe 2020 janë më të ulëta se vlerat bazë për vitin 2017 sepse, falë regjimit të përforcuar të zbatimit në vitin 2017, numri i shkeljeve pritet të ulet në vitet në vazhdim.

Objektivi A6 Forcimi i regjimit të kontrolleve mbi financimin e partive politike

A.6.c Financat e partive politike të audituara në përputhje me rekomandimet e BE/ACFA

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës Raporti vjetor Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Frekuenca e publikimit të të dhënave Çdo vit

Përshkrim i shkurtër i metodologjisë Ndryshimi dhe zbatimi i Kodit Zgjedhor të miratuar dhe Ligji për Partitë Politike, si edhe aktet nënligjore në përputhje me rekomandimet e BE-së dhe projektit ACFA, do të sjellin si pasojë

- thjeshtësimin e raportimit financiar dhe kërkesave të auditimit, të raportimit dhe publikimit të raportit financiar të KQZ-së;
- masat për të ngritur një strukturë të përshtatshme për kontrollin dhe verifikimin e pavarur të raporteve të auditimit;
- përmirësime të procedurës së brendshme dhe qartësimi i përgjegjësive të stafit të KQZ-së për kontrollin e financimit të partive politike.

Performanca do të vlerësohet duke matur rritjen e numrit total të raporteve financiare vjetore dhe, nëse ka, raportet financiare të fushatës dhe raportet përfundimtare të auditimit të 5 partive më të mëdha politike, krahasuar me vitin e mëparshëm.

Informacioni për vlerat bazë	Viti	2015	2016	2017
	Vlera bazë		-	-

Informacioni për vlerat e synuara	Viti	2018	2019	2020
	Vlera e synuar		5	5

SHËNIM: Ky Tregues është Treguesi i Disbursimit numër 2 i “Kontratës së reformës së Sektorit të BE-së për luftën kundër korrupsionit në Shqipëri” 2017-2020

Objektivi A7

Përmirësimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut

A.7.a Raporti i rekomandimeve të auditimit të brendshëm të pranuar dhe zbatuara nga subjektet publike

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës

Raporti Vjetor për Kontrollin dhe Financimin e Brendshëm Publik

Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Frekuenca e publikimit të të dhënave

Çdo vit

Përshkrim i shkurtër i metodologjisë

Ky tregues tregon shkallën e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga Njësitë e Auditimit të Brendshëm. Treguesi do të matet nëpërmjet dy nën-treguesve:

Nën-treguesi A.7.a.1: Rekomandimet e dhëna nga AB-të dhe të pranuar nga institucionet. Ky tregues bazohet në supozimin se AB-të duhet të marrin një përgjigje nga njësitë/ strukturat e audituara, duke pranuar se kanë marrë një raport të AB-së me rekomandime të dhëna nga auditorët dhe duke informuar AB-në për masat e marra për të trajtuar rekomandimet.

Nën-treguesi A.7.a.2: Numri i rekomandimeve të dhëna nga AB-të dhe të zbatuara nga institucionet

Performanca do të vlerësohet duke matur rritjen në % të të dy raporteve. Formulatat specifike të përdorura për treguesin do të jenë:

- **Nën-treguesi A.7.a.1:** Raporti i rekomandimeve të dhëna nga AB-të dhe numri total i rekomandimeve të pranuar nga institucionet;

$$R_{Acc.} = \frac{\sum \text{e numrit të rekomandimeve të pranuar nga Drejtuesit}}{\sum (\text{Numri i rekomandimeve të dhëna nga njësitë e AB})} \times 100\%$$

- **Nën-treguesi A.7.a.2:** Raporti i rekomandimeve të zbatuara nga institucionet mbi numrin total të rekomandimeve të pranuar.

$$R_{Impl.} = \frac{\sum (\text{Numri i rekomandimeve të zbatuara nga institucionet brenda 2 viteve})}{\sum (\text{Numri i rekomandimeve të pranuar})} \times 100\%$$

Objektivi A7

Përmirësimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut

A.7.a Raporti i rekomandimeve të auditimit të brendshëm të pranuar dhe zbatuara nga subjektet publike

Informacioni për vlerat bazë	Viti	2015	2016	2017
	Vlera Bazë A.7.a.1	62.4%	47%	Të disponueshme në Maj 2018
	Vlera Bazë A.7.a.2	-	-	-
Informacioni për vlerat e synuara	Viti	2018	2019	2020
	Vlera e synuar	Trend në rritje, krahasuar me vitin e mëparshëm - minimumi 3% rritje	Trend në rritje, krahasuar me vitin e mëparshëm - minimumi 3% rritje	Trend në rritje, krahasuar me vitin e mëparshëm - minimumi 3% rritje

Objektivi A7

Përmirësimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut

A.7.b Numri i rasteve që vijnë nga auditime të brendshme që raportohen për hetim financiar

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës Raporti Vjetor për Inspektimin Financiar Publik

Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Frekuenca e publikimit të të dhënave Çdo vit

Përshkrim i shkurtër i metodologjisë Hartimi i raportit të aktivitetit vjetor të Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik përbën një detyrim ligjor dhe i paraqitet Nëpunësve Autorizues dhe Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nga 31 marsi i vitit të ardhshëm. Hartimi i raportit vjetor të aktiviteteve të Inspektimit Financiar Publik ka për qëllim prezantimin e aktiviteteve të Inspektimit Financiar Publik, objektivave dhe performancës së Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik dhe objektivave të vendosura për periudhën në vazhdim, zbatimin e objektivave strategjike të qeverisë dhe të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ashtu si edhe zbatimin e masave për të përmbushur objektivat dhe strategjitë.

Performanca do të vlerësohet duke matur rritjen e numrit të rasteve që vijnë nga auditime të brendshme të cilat referohen për inspektime financiare.

Informacioni për vlerat bazë	Viti	2015	2016	2017
	Vlera bazë		6	4

Informacioni për vlerat e synuara	Viti	2018	2019	2020
	Vlera e synuar		Trend në rritje, krahasuar me vitin e mëparshëm - minimumi 3% rritje	Trend në rritje, krahasuar me vitin e mëparshëm - minimumi 3% rritje

Objektivi A7

Përmirësimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut

A.7.c Numri i referimeve në prokurori si pasojë e inspektimeve financiare

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Raporti Vjetor për Inspektimin Financiar Publik			
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Ministria e Financave dhe Ekonomisë			
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Çdo vit			
Përshkrim i shkurtër i metodologjisë	Aty ku të dhënat nga inspektimet financiare sjellin dyshime të arsyeshme për ekzistencën e një shkeljeje, (duke iu referuar gjetjeve në raportet e inspektimit përfundimtar) Nëpunësi Kryesor Autorizues informon Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe raporton rastin në Prokurori. Performanca vlerësohet duke matur rritjen e numrit të raportimeve në Prokurori si rezultat i inspektimeve financiare.			
Informacioni për vlerat bazë	Viti	2015	2016	2017
	Vlera bazë	1	4	5
Informacioni për vlerat e synuara	Vlera e synuar	2018	2019	2020
		Trend në rritje, krahasuar me vitin e mëparshëm - minimumi 3% rritje	Trend në rritje, krahasuar me vitin e mëparshëm - minimumi 3% rritje	Trend në rritje, krahasuar me vitin e mëparshëm - minimumi 3% rritje

Objektivi A7

Përmirësimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut

A.7.d Numri i inspektimeve financiare të kryera nga Njësia e Inspektimit Financiar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesve të performancës Raporti vjetor - Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Frekuenca e publikimit të të dhënave Çdo vit

Përshkrim i shkurtër i metodologjisë Rritja e kapaciteteve dhe funksionimi i Njesisë së Inspektimit Financiar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë do të sjellë rritje të numrit të inspektimeve financiare.

Numri i inspektimeve varet nga numri i rasteve të raportuara - duke qenë se ky numër pritet të rritet në një periudhë afat-mesme deri në afat-gjatë, edhe numri i inspektimeve do të rritet.

Performanca do të vlerësohet duke matur numrin total të inspektimeve financiare të kryera nga Njësia e Inspektimit Financiar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Informacioni për vlerat bazë	Viti	2015	2016	2017
	Vlera bazë		5	-

Informacioni për vlerat e synuara	Viti	2018	2019	2020
	Vlera e synuar		30	35

SHËNIM: Ky Tregues është Treguesi i Disbursimit numër 4 i “Kontratës së reformës së Sektorit të BE-së për luftën kundër korrupsionit në Shqipëri” 2017-2020

A.8 Numri i institucioneve publike që kanë kryer analiza vjetore për prirjet për korrupsion

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës Raporti vjetor i MD/KKK

Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave MD/KKK

Frekuenca e publikimit të të dhënave Çdo vit

Përshkrim i shkurtër i metodologjisë Në institucionet publike (Ministritë, Drejtoritë ose Njësitë) do të përcaktohen dy lloje dobësish ose rreziqesh për korrupsion:

1. Veprimtari profesionale që lidhen me p.sh. paratë, informacionin konfidencial, dhënia e lejeve, dhënie të kontratave, etj.;
2. Dobësi organizative. Kjo lidhet me disa procese të cilat mund të priren drejt shkeljeve të integritetit ose drejt korrupsionit, p.sh. përzgjedhja dhe rekrutimi i personelit, prokurimi dhe përpunimi i informacioneve konfidenciale.

Së bashku ata krijojnë rreziqe të mundshme ndaj të cilave është e ekspozuar organizata.

Për më tepër, do të vlerësohet nëse këto rreziqe mbulohen mjaftueshëm nga rregullat dhe rregulloret administrative ekzistuese, dhe nëse ato janë aq të forta sa të minimizojnë rreziqet e korrupsionit. Për rrjedhojë, fokusi përqendrohet në përshtatshmërinë e rregullave, udhëzimeve, procedurave të mira (cilësore) për t'u përballur me aktivitetet me dobësi. Nëse ekziston një mangësi, rekomandimet do të jepen të tilla që të forcojnë rezistencën kundër korrupsionit dhe të ngulisin këtë gjë në organizatë.

Vlerësimi i rreziqeve do të zbatohet në përputhje me ISO 31010/2009 - Teknika e Menaxhimit të rreziqeve dhe Vlerësimit të rreziqeve dhe/ose udhëzimi i metodologjisë së Vlerësimit të Rrezikut për Korrupsion⁶ (KE - Projekti PACA, 2010).

Performanca do të vlerësohet duke matur rritjen e numrit total të vlerësimeve të rreziqeve.

Informacioni për vlerat bazë	Viti	2015	2016	2017
	Vlera bazë	-	-	-

A.8 Numri i institucioneve publike që kanë kryer analiza vjetore për prirjet për korrupsion

Informacioni për vlerat e synuara	Viti	2018	2019	2020
Vlera e synuar (procesi)		Janë hartuar dhe pranuar udhëzimet (manuali) për kryerjen e një vlerësimi të rrezikut në institucionet publike si pjesë e një plani integriteti. Është hartuar një program trajnimi lidhur me zbatimin e manualit. Po zbatohet një plan veprimi ndër-institucional për kryerjen e vlerësimeve të rreziqeve.		
Vlera e synuar (performanca)			Instrumenti i hartuar për vlerësimin e rrezikut po zbatohet në 10 Ministri.	10 Ministritë kanë zbatuar vlerësimin e rrezikut.

⁶ Këshilli i Evropës, Projekti kundër Korrupsionit në Shqipëri, 2010 - <https://rm.coe.int/16806ec890>

A.9 Numri i ministrive që kanë zhvilluar dhe publikuar një plan integriteti në përputhje me strategjinë ndër-sektoriale kundër korrupsionit

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës Raporti vjetor i MD/KKK

Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave MD/KKK

Frekuenca e publikimit të të dhënave Çdo vit

Përshkrim i shkurtër i metodologjisë Një plan integriteti do të sigurojë kuadrin konceptual për politikën dhe masat për të parandaluar shkeljet e integritetit të nëpunësve publikë dhe për të monitoruar efektet e masave të zbatuara në një institucion publik. Ai përmban informacione rreth (ndër të tjera):

- Fushave specifike të prirura drejt korrupsionit në institucionet publike.
- Fushat e etikës dhe integritetit personal, p.sh. kodi i sjelljes, pranimi i dhuratave, raportimi i korrupsionit (përfshirë sinjalizimin), masat disiplinore (të regjistruara), përgjigjet ndaj sjelljeve të papranueshme morale dhe profesionale, trajnimi për etikën;
- Instrumenti për vlerësimin e rrezikut.
- Një vizion për luftën kundër korrupsionit brenda organizatës

Institucionet do të hartojnë planin e tyre të integritetit bazuar në Udhëzimet e miratuara për zhvillimin dhe zbatimin e planit të integritetit, të hartuar nga MD/KKK dhe i përshtatur sipas llojeve dhe kompetencave të ndryshme të institucioneve.

Performanca do të vlerësohet duke matur rritjen e numrit total të planeve të integritetit të miratuara dhe të publikuara.

Informacioni për vlerat bazë	Viti	2015	2016	2017
	Vlera bazë		-	-
Informacioni për vlerat e synuara	Viti	2018	2019	2020
	Vlera e synuar (procesi)	Një model (strukturë) për një plan integriteti në Shqipëri, i hartuar, i pranuar dhe i publikuar nga MD-ja.		
	Vlera e synuar (performanca)		10 ministri kanë miratuar dhe publikuar një plan integriteti	10 ministri kanë miratuar dhe zbatuar një plan integriteti

Objektivi A10 Analizimi i prirjeve të korrupsionit dhe përmirësimi i statistikave në lidhje me veprimtarinë e agjencive ligjzbatuese kundër korrupsionit

A.10 Statistika të konsoliduara dhe të harmonizuara për korrupsionin prodhohen dhe publikohen në mënyrë periodike.

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës Drejtoria e Përgjithshme e Policisë; Zyra e Prokurorisë, Gjykata e Shkallës së Parë, Gjykata e Apelit, Gjykata e Lartë⁷

Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave Ministria e Drejtësisë

Frekuenca e publikimit të të dhënave Çdo gjashtë muaj (Janar dhe Gusht) - Për momentin shpërndahen vetëm brenda institucionit dhe nuk publikohen.

Përshkrim i shkurtër i metodologjisë Çdo gjashtë muaj, Sektori i Statistikave mbledh, konsolidon dhe prodhon statistika të konsoliduara dhe të harmonizuara për korrupsionin dhe krimin e organizuar - Këto statistika shpërndahen vetëm në nivel institucional dhe me Komisionin Evropian, por nuk publikohen. Raporti publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë si pjesë e raportit vjetor.

Procesi i mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave duhet të përforcohet për të garantuar që statistikat e harmonizuara dhe të konsoliduara të përfshijnë të dhëna të përshtatshme sipas praktikave më të mira ndërkombëtare përkatëse, ndër të tjera rekomandimi i 33-të i FATF për statistikat ⁸.

Statistikat e harmonizuara dhe të konsoliduara do të shndërrohen në një instrument funksional për të raportuar, ndër të tjera, për Treguesin B1 dhe çdo tregues tjetër lidhur me ndalimin e korrupsionit.

Raporti statistikor karakterizohet nga disa kriteret thelbësore cilësore, duke siguruar kapacitetet për të ndjekur një çështje që nga faza e hetimit deri në dënim. Prandaj, përmbledhja e rasteve do të plotësohet nga një bazë të dhënash e cila përshkruan situatën specifike për (të paktën):

- A. Numrin e hetimeve të nisura
- B. Numrin e kallëzimeve të kërkuara nga Prokuroria
 - 1) Numrin e kërkesave për sekuestrim⁹
- C. Numri i dënimeve
 - 1) Numri i kërkesave të miratuara për sekuestrim¹⁰
 - 2) Numri i kërkesave të miratuara për konfiskim
- D. Të dhënat për administrimin e pasurive¹¹:
 - 1) Vlera e pasurive të sekuestruara nën administrim
 - 2) Vlera e pasurive të konfiskuara nën administrim
 - 3) Vlera e realizuar nga shitja e pasurive të konfiskuara
 - 4) Numri i pasurive të kthyera pronarit
 - 5) Numri i pasurive të shkatërruara
 - 6) Vlera monetare e transferuar në buxhetin e shtetit pas shitjes

Treguesi do të vlerësohet duke matur përmirësimin e mekanizmit të raportimit të statistikave (procesi) dhe publikimin e tij dy herë në vit (performanca).

Objektivi A10 Analizimi i prirjeve të korrupsionit dhe përmirësimi i statistikave në lidhje me veprimtarinë e agjencive ligjzbatuese kundër korrupsionit

A.10 Statistika të konsoliduara dhe të harmonizuara për korrupsionin prodhohen dhe publikohen në mënyrë periodike.

Informacioni për vlerat bazë	Viti	2015	2016	2017
	Vlera bazë		1	1

Informacioni për vlerat e synuara	Viti	2018	2019	2020
	Vlera e synuar (procesi)		Statistikat prodhohen dhe publikohen një herë në vit	Përmirësimi i mekanizmit të raportimit të statistikave duke përfshirë (nga lista më sipër): - A, B, C1, D1
Vlera e synuar (performanca)		-	-	Prodhohen dhe publikohen dy herë në vit

⁷ Kur të jenë funksionale institucionet e reja nën Reformën e Drejtësisë, ato do të bëhen një burim të dhënash për këtë tregues

⁸ Rekomandimi i 33-të i Task Forcës për Masat Financiare ka rëndësi të veçantë për AML-në dhe CFT-në, por parimet e tij, bashkë me rekomandimet praktike që janë pjesë e manualit të udhëzimeve për të dhënat dhe statistikën janë të përshtatshme si për OC ashtu edhe për Korrupsionin (2015 - shih <http://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/reports/AML-CFT-related-data-and-statistics.pdf>)

⁹ Statistikat do të merren nga sistemi i ri që do të ndërtohet për të raportuar rreth Treguesit B.1.b

¹⁰ Statistikat do të merren nga sistemi i ri që do të ndërtohet për të raportuar rreth Treguesit B.1.b dhe Treguesit e Pasaportës të Strategjisë për Reformën në Sektorin e Drejtësisë.

¹¹ Statistikat e përmendura në pikat D1, D2, D3, D4, D5 dhe D6 do të vijnë së pari nga mekanizmi i ri i raportimit i kërkuar nga Treguesi B.1.c.

A.11.a Raporti i bashkive që kanë hartuar plane vendore anti-korrupsion dhe plane integriteti (në përputhje me strategjinë ndër-sektoriale kundër korrupsionit)

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesve të performancës	Raporti vjetor i Agjencisë në mbështetje të Vetë-Qeverisjes Vendore
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Ministria e Brendshme
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Çdo vit
Përshkrim i shkurtër i metodologjisë	<p>Një plan integriteti do të sigurojë kuadrin konceptual për politikën dhe masat për të parandaluar shkeljet e integritetit të nëpunësve publikë dhe për të monitoruar efektet e masave të zbatuara në një institucion publik. Ai përmban informacione rreth (p.sh.):</p> <ul style="list-style-type: none">· Fushave specifike të prirura drejt korrupsionit në bashki.· Fushat e etikës dhe integritetit personal, p.sh. kodi i sjelljes, pranimiti i dhuratave, raportimi i korrupsionit (përfshirë sinjalizimin), masat disiplinore (të regjistruara), përgjigjet ndaj sjelljeve të papranueshme morale dhe profesionale, trajnimit për etikën;· Instrumenti për vlerësimin e rrezikut.· Një vizion për luftën kundër korrupsionit brenda bashkisë <p>Promovimi i planeve vendore të integritetit në nivel bashkiak do të krijojë gjithashtu mundësi të tjera që qytetarët të njohin përpjekjet anti-korrupsion dhe të kontribuojnë në mënyrë aktive ndaj tyre.</p> <p>Bashkitë do të hartojnë planin e tyre të integritetit bazuar në Udhëzimet e miratuara për zhvillimin dhe zbatimin e planit të integritetit, të hartuar nga MD/KKK (referojuni A9).</p> <p>Performanca do të vlerësohet së pari me hartimin e udhëzimeve (procesi) dhe më pas me rritjen e % të bashkive që kanë miratuar dhe publikuar një plan vendor të integritetit (performanca). Formula specifike e përdorur për treguesin do të jetë:</p> $L_{int.} = \frac{\sum \text{e numrit të bashkive që kanë miratuar dhe publikuar një plan vendor integriteti}}{\sum \text{e numrit të bashkive}} \times 100\%$

Objektivi A11 Adoptimi i politikave kundër korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore

A.11.a Raporti i bashkive që kanë hartuar plane vendore anti-korrupsion dhe plane integriteti (në përputhje me strategjinë ndër-sektorale kundër korrupsionit)

Informacioni për vlerat bazë	Viti	2015	2016	2017
	Vlera bazë		-	-

Informacioni për vlerat e synuara	Viti	2018	2019	2020
	Vlera e synuar (procesi)		Hartimi i Udhëzimeve (referojuni A9). MB i përcjell udhëzime të gjitha Bashkive	Këto Udhëzime shpërndahen në mënyrë aktive nga MB në të gjitha Bashkitë, ndër të tjera përmes seancave të ndërmjetme informuese.
Vlera e synuar (performanca)			5 bashki hartuan dhe miratuan një Plan Vendor të Integritetit	10 bashki hartuan dhe miratuan një Plan Vendor të Integritetit.

Objektivi A11 Adoptimi i politikave kundër korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore

A.11.b Numri i Bashkive që alokojnë një zë të veçantë të buxhetit për zbatimin e politikës vendore anti-korrupsion

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës Raporti vjetor i Agjencisë në mbështetje të Vetë-Qeverisjes Vendore

Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave Ministria e Brendshme

Frekuenca e publikimit të të dhënave Çdo vit

Përshkrim i shkurtër i metodologjisë Alokimi i zërave të veçanta të buxhetit për zbatimin e planeve vendore është thelbësore për të garantuar efektivitetin e ndikimit të këtij plani, si dhe performancën e përgjithshme mbi anti-korrupsionin në nivel vendor. Performanca do të vlerësohet së pari duke matur numrin total të bashkive të cilat kanë ndarë të paktën 1% të buxhetit vjetor për zbatimin e planit vendor të integritetit.

Informacioni për vlerat bazë	Viti	2015	2016	2017
	Vlera bazë		-	-

Informacioni për vlerat e synuara	Viti	2018	2019	2020
	Vlera e synuar		-	-

B.1.a Numri i kallëzimeve për korrupsion (rastet dhe personat)

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesve të performancës	Statistikat e harmonizuara për raportin e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (raporti i brendshëm i dorëzuar në BE)
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Prokuroria e Përgjithshme ¹²
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Në baza 6 mujore (janar dhe gusht)
Përshkrim i shkurtër i metodologjisë	<p>Hetimet, të zbatuara nga agjencitë e zbatimit të ligjit nën koordinimin dhe udhëheqjen e Prokurorisë, do të sjellin hartimin e kallëzimit nga Prokuroria dhe paraqitjen e tyre në Gjykata. Pritet rritja e efektivitetit të hetimeve, duke sjellë rritjen e numrit të kallëzimeve. Një vlerësim i plotë do të marrë në konsideratë si rastet ashtu edhe personat.</p> <p>Performanca do të vlerësohet duke matur rritjen e numrit total të kallëzimeve për korrupsion. Treguesi do të matet si nga numri i rasteve ashtu edhe nga numri i personave të përfshirë në kallëzime.</p>

Është përfshirë një nën-tregues shtesë, për të vlerësuar performancën në kontekstin specifik e të ashtuquajturave “raste të korrupsionit të nivelit të lartë”. Në këtë kuadër, “çështjet e nivelit të lartë” përkufizohen ato që lidhen me nenet 245 dhe 260 të Kodit Penal (që parashikojnë përkatësisht dënimin minimal prej 1 dhe 4 vjet). Llogaritja e raportit do të kryhet si më poshtë:

Nën-treguesi B.1.a.1: Raporti i kallëzimeve për “korrupsion të nivelit të lartë” mbi numrin total të kallëzimeve për korrupsion;

$$R_{HLC} = \frac{\sum \text{e numrit të kallëzimeve për korrupsion 'të nivelit të lartë'}}{\sum \text{e numrit të kallëzimeve për korrupsion}} \times 100\%$$

SHËNIM: Efektiviteti i hetimit lidhet gjithashtu me numrin e kallëzimeve që gjenerojnë dënime përfundimtare - ky element (i cili nuk varet vetëm nga hetimet, por, në mënyrë thelbësore, nga kryerja e procedurave gjyqësore) do të matet nga Pasaporta e Treguesve të Strategjisë së Reformës në Sektorin e Drejtësisë.

Objektivi B1

Përmirësimi i efiçencës dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit

B.1.a Numri i kallëzimeve për korrupsion (rastet dhe personat)

Informacioni për vlerat bazë	Viti	2015	2016	2017
	Baza për Treguesin B.1.a	Raste të dërguara në gjykatë: 689 Individët e akuzuar: 1011	Raste të dërguara në gjykatë: 617 Individët e akuzuar: 874	Raste të dërguara në gjykatë: 813 Individët e akuzuar: 974
	Baza për Nën-treguesit B.1.a.1	0% e rasteve 0,099% e të akuzuarve	0,16 % e rasteve 0,11% e të akuzuarve	0,24 % e rasteve 0,62% e të akuzuarve
Informacioni për vlerat e synuara	Viti	2018	2019	2020
	Objektivi për Treguesin B.1.a	Raste të dërguara në gjykatë: 855 Individët e akuzuar: 1022 ¹³	Raste të dërguara në gjykatë: 897 Individët e akuzuar: 1073	Raste të dërguara në gjykatë: 941 Individët e akuzuar: 1126
	Objektivi për Nën-treguesit B.1.a.1	0,5% e rasteve 1% e të akuzuarve	0,8 % e rasteve 1,5 % e të akuzuarve	1 % e rasteve 2 % e të akuzuarve

¹² Zëvendësohet nga Prokuroria E Veçantë Kundër Korrupsionit (SPAK), kur të jetë plotësisht funksionale

¹³ Është marrë në konsideratë një rritje prej 5%

B.1.b Numri i kërkesave për sekuestrimin e pasurive në rastet e korrupsionit

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Statistikat e harmonizuara për raportin e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (raporti i brendshëm i dorëzuar në BE)
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Prokuroria e Përgjithshme ¹⁴
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Çdo gjashtë muaj (janar dhe gusht)

Përshkrim i shkurtër i metodologjisë Sekuestrimi dhe konfiskimi i të ardhurave nga krimi paraqet një mjet kritik shtrëngues për korrupsionin, duke hequr stimujt financiarë për veprimtarinë kriminale. Rritja e efektivitetit të hetimeve (që ndër të tjera, përfshinin hetime financiare dhe procedura të gjurmimit të pasurive më të mira) pritet që, ndër të tjera, të rrisë numrin e kërkesave për sekuestrim të paraqitura nga Prokuroria në Gjykatë.

Deri në fund të vitit 2017, këto të dhëna nuk gjurmohen nga statistikat e Prokurorisë. Mekanizmi gjurmues për statistikën e harmonizuar për korrupsionin dhe krimin e organizuar do të përditësohet për të gjeneruar këto të dhëna dhe do të përfshijë shifra në të gjitha raportet gjashtë mujore.

Treguesi do të vlerësohet duke matur së pari përmirësimin e sistemit të gjurmimit (procesi) dhe më pas rritjen e numrit total të kërkesave për sekuestrim në rastet e korrupsionit (performanca). Treguesi do të matet si nga numri i rasteve ashtu edhe nga numri i personave të përfshirë në kallëzime.

Deri në vitin 2020, do të përfshihet një nën-tregues tjetër, për të vlerësuar performancën në kontekstin e veçantë të të ashtuquajturve “raste të korrupsionit në nivel të lartë”. Në këtë kuadër, “çështjet e nivelit të lartë” përkufizohen ato që lidhen me nenet 245 dhe 260 të Kodit Penal (që parashikojnë përkatësisht dënimin minimal prej 1 dhe 4 vjet). Llogaritja e raportit do të kryhet si më poshtë:

Nën-treguesi B.1.a.1: Raporti i kërkesave për sekuestrim në rastet e “korrupsionit në nivel të lartë” mbi numrin total të kërkesave për sekuestrim në rastet e korrupsionit;

$$R_{HLC} = \frac{\sum \text{e numrit të kërkesave për sekuestrim në rastet e korrupsionit 'të nivelit të lartë'}}{\sum \text{e numrit total të kërkesave për sekuestrim në raste korrupsioni}} \times 100\%$$

SHËNIM: efektiviteti i hetimit lidhet gjithashtu me numrin e konfiskimeve - ky element (i cili nuk varet vetëm nga hetimet, por, në mënyrë thelbësore, nga kryerja e procedurave gjyqësore) do të matet me Pasaportën e Treguesve të Strategjisë së Reformës në Sektorin e Drejtësisë.

Objektivi B1 Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit

B.1.b Numri i kërkesave për sekuestrimin e pasurive në rastet e korrupsionit

Informacioni për vlerat bazë	Viti	2015	2016	2017
	Vlera bazë	-	-	-
Informacioni për vlerat e synuara	Viti	2018	2019	2020
	Vlera e synuar (procesi)	Ndërtimi i mekanizmit raportues (dhe/ose përditësimi i gjurmimit të statistikave të harmonizuara) me qëllim përfshirjen e të dhënave të reja	Të dhëna të publikuara në raporte dy-vjeçare	-
	Vlera e synuar (performanca)	-	-	5% rritje krahasuar me bazën e 2019

¹⁴ Zëvendësohet nga Prokuroria e Veçantë Kundër Korrupsionit (SPAK), kur të jetë plotësisht funksionale

B.1.c Vlera e parashikuar e të ardhurave nga krimi të sekuestruara në rastet e korrupsionit

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës Raportet dyvjeçare të AAPSK-së

Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK)

Frekuenca e publikimit të të dhënave Dy-vjeçare (janar dhe gusht)

Përshkrim i shkurtër i metodologjisë Sekuestrimi dhe konfiskimi i të ardhurave nga krimi paraqet një mjet kritik shtrëngues për korrupsionin, duke hequr stimujt financiarë për veprimtarinë kriminale. Hetimet efektive do të gjenerojnë jo vetëm kërkesa shtesë për sekuestrim (shih treguesin B.1.c), por edhe rritjen e vlerës së agreguar të pasurive të sekuestruara. Vlerësimi i këtyre të dhënave shtesë 15shtë thelbësor për të pasur një tablo të plotë të efektivitetit të hetimeve mbi korrupsionin

Bazuar në kuadrin ligjor shqiptar, 16pasuritë për të cilat është miratuar sekuestrimi do t'i dorëzohen AAPSK-së për administrim. Pas marrjes së pasurive, Agjencia zbaton një vlerësim të brendshëm dhe cakton një vlerë të parashikuar. Pas konfiskimit, kjo vlerë vlerësohet më pas nga ekspertë të jashtëm

Deri në fund të vitit 2017, këto të dhëna nuk do të gjurmohen nga AAPSK. Mekanizmi i raportimit të brendshëm të Agjencisë do të përditësohet me qëllim gjenerimin e këtyre të dhënave, dhe do të përfshijë shifra në të gjitha raportet gjashtë mujore.

Treguesi do të vlerësohet duke matur së pari përmirësimin e monitorimit të brendshëm të AAPSK-së (procesi) dhe më pas rritjen e vlerës totale të pasurive të sekuestruara në rastet e korrupsionit (performanca).

SHËNIM: efektiviteti i hetimit lidhet gjithashtu me vlerën e konfiskimeve përfundimtare - ky element (i cili nuk varet vetëm nga hetimet, por, në mënyrë thelbësore, nga kryerja e procedurave gjyqësore) do të matet me Pasaportën e Treguesve të Strategjisë së Reformës në Sektorin e Drejtësisë.

Objektivi B1 Përmirësimi i efiçencës dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit

B.1.c Vlera e parashikuar e të ardhurave nga krimi të sekuestruara në rastet e korrupsionit

Informacioni për vlerat bazë	Viti	2015	2016	2017
	Vlera bazë	E papërcaktuar	E papërcaktuar	E papërcaktuar
Informacioni për vlerat e synuara	Viti	2018	2019	2020
Vlera e synuar (procesi)	Përmirësimi i mekanizmit të raportimit të brendshëm të AAPSK-së për mbledhjen e të dhënave dhe raportimin e vlerave të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara		Të dhënat e publikuara në raportet gjashtë mujore të AAPSK-së	-
Vlera e synuar (performanca)		-	-	5% rritje krahasuar me bazën e 2019

¹⁵ Në përputhje me, ndër të tjera, rekomandimet e FATF dhe me Direktivën e 4-të të BE-së për pastrimin e parave

¹⁶ Agjencia nuk ka një ligj organik, por veprimtaria e saj rregullohet me VKM nr. 687, datë 05.10.2011.

Objektivi B2

Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndëshkimin penal të korrupsionit

B.2.a Raporti i procedurave të regjistruara mbi korrupsionin nga referimet e administruara

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës Statistikat e harmonizuara për raportin e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (raporti i brendshëm i dorëzuar në BE)

Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave Prokuroria e Përgjithshme¹⁷

Frekuenca e publikimit të të dhënave Çdo gjashtë muaj (janar dhe gusht)

Përshkrim i shkurtër i metodologjisë Të dhënat do t'i raportohen Prokurorisë së Përgjithshme nga Prokuroritë e Shkallës së Parë, në përputhje me formatin e tyre të të dhënave. Zyra për Statistikat në Prokurorinë e Përgjithshme do të përpunojë të dhënat vetëm për ato nene të Kodit Penal që raportohen në statistikën e harmonizuar nën zërin "korrupsion".

Performanca do të vlerësohet duke matur raportin mes procedimeve të regjistruara për korrupsion dhe numrit total të raportimeve të administruara.

$$R_{PR.C} = \frac{\sum \text{e numrit të procedimeve të regjistruara për korrupsion}}{\sum \text{e numrit total të raportimeve administrative të regjistruara}} \times 100\%$$

Informacioni për vlerat bazë	Viti	2015	2016	2017
	Vlera bazë		67.68 %	65.86 %
Informacioni për vlerat e synuara	Viti	2018	2019	2020
	Vlera e synuar	70 %	75 %	80 %

¹⁷ Zëvendësohet nga Prokuroria E Veçantë Kundër Korrupsionit (SPAK), kur të jetë plotësisht funksionale

Objektivi B2

Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndëshkimin penal të korrupsionit

B.2.b Numri i aksesit në bazat e të dhënave shtesë për policinë dhe prokurorinë

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Raportet Vjetore të Prokurorisë së Përgjithshme Raportet Vjetore të Policisë së Shtetit
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Prokuroria e Përgjithshme Policia e Shtetit
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Çdo vit
Përshkrim i shkurtër i metodologjisë	<p>Përmirësimi i aksesit në bazat e të dhënave dhe në të dhënat publike nga policia dhe prokuroria është e rëndësishme për rritjen e efektivitetit të hetimeve, ndjekjeve penale dhe ndëshkimit të korrupsionit.</p> <p>Në mënyrë që të rritet numri i bazave të të dhënave të aksesueshme nga Prokuroria e Përgjithshme dhe Policia e Shtetit, të dy institucionet duhet të nënshkruajnë memorandume mirëkuptimi me institucionet që zotërojnë bazat e të dhënave, ndërsa Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale siguron financimin dhe stafin e trajnuar për përdorim dhe mirëmbajtje.</p> <p>Performanca do të vlerësohet duke matur numrin total të bazave të të dhënave të aksesueshme nga Prokuroria dhe Policia e Shtetit.</p>

Informacioni për vlerat bazë	Viti	2015	2016	2017
Vlera bazë		-	Policia ka akses në 8 baza të dhënash	Policia ka akses në 10 baza të dhënash
			Prokuroria ka akses në 3 baza të dhënash	Prokuroria ka akses në 8 baza të dhënash

Informacioni për vlerat e synuara	Viti	2018	2019	2020
Vlera e synuar		Policia ka akses në 2 baza të dhënash shtesë ¹⁸	Policia ka akses në 2 baza të dhënash shtesë	Policia ka akses në 2 baza të dhënash shtesë
		Prokuroria ka akses në 3 baza të dhënash shtesë	Prokuroria ka akses në 3 baza të dhënash shtesë	Prokuroria ka akses në 4 baza të dhënash shtesë

SHËNIM: Ky Tregues është Treguesi i Disbursimit numër 3 i “Kontratës së reformës së Sektorit të BE-së për luftën kundër korrupsionit në Shqipëri” 2017-2020

¹⁸ Për të gjitha objektivat, shifrat e bazës së të dhënave shtesë duhet të vlerësohen krahasuar me vitin e mëparshëm.

B.3.a Numri i raporteve të rishikimit të hartuara në mënyrë periodike dhe të bëra publike nga Ministria e Drejtësisë mbi përshtatshmërinë e kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimeve ekonomike dhe financiare

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesve të performancës	Raporti Vjetor i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Çdo vit
Përshkrim i shkurtër i metodologjisë	<p>Rishikimi i brendshëm i përshtatshmërisë së kuadrit ligjor, përfshirë bashkërendimin me standardet ndërkombëtare dhe pengesat dhe mbivendosjet e legjislacionit ekzistues kombëtar, paraqet një dialog thelbësor dhe mundësi përmirësimi.</p> <p>Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të zbatojë çdo vit një sërë aktiviteteve për konsultim dhe rishikim të fushave specifike të kuadrit ligjor. Këto instrumente mund të përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none">· Tryeza të rrumbullakëta· Sondazhe për praktikuesit· Intervista për praktikuesit· Diskutime ndërmjet praktikuesve dhe akademisë· Takime të përbashkëta për tema të veçanta të kuadrit ligjor <p>Përzgjedhja e temave do të kryhet në fillim të vitit dhe takimet do të planifikohen paraprakisht për të siguruar pjesëmarrjen e duhur nga ana e komunitetit të praktikantëve. Temat që mbulohen nga rishikimi mund të lidhen me prioritetet e përcaktuara për vitin specifik, ndër të tjera për të përmbushur objektivat e treguesve të veçantë të Strategjisë Anti-Korrupsion.</p> <p>Rishikimi do të përputhet dhe do të përmirësojë hartimin e politikave të bazuara në dëshmi, siç përcaktohet nga Paketa e Instrumenteve numër 4¹⁹ për Rregullimin më të Mirë të Bashkimit Evropian. Aktivitetet e kryera gjatë vitit do të pasqyrohen në një raport të politikave të vendosura në dispozicion të politikë bërësve, ligjvënësve, grupeve të interesit dhe praktikuesve.</p> <p>Treguesi do të vlerësohet duke matur ngritjen e rishikimeve (procesit) dhe dorëzimin e raporteve të rishikimit tek politikë bërësit (performanca).</p>

B.3.a Numri i raporteve të rishikimit të hartuara në mënyrë periodike dhe të bëra publike nga Ministria e Drejtësisë mbi përshtatshmërinë e kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimeve ekonomike dhe financiare

Informacioni për vlerat bazë	Viti	2015	2016	2017
	Vlera bazë		-	-

Informacioni për vlerat e synuara	Viti	2018	2019	2020
	Vlera e synuar (procesi)	Zbatimi i një mase rishikuese		
	Vlera e synuar (performanca)		Një raport rishikimi i publikuar dhe i dorëzuar tek politike bërësit	Një raport rishikimi i publikuar dhe i dorëzuar tek politikë bërësit

¹⁹ https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/file_import/better-regulation-toolbox-4_en_o.pdf

B.3.b Zbatimi i legjislacionit për ngritjen e një Zyre të Rikuperimit të Pasurive

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesve të performancës Raporti Vjetor i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave Ministria e Financave dhe Ekonomisë²⁰

Frekuenca e publikimit të të dhënave Çdo vit

Përshkrim i shkurtër i metodologjisë Privimi i kriminelëve nga përfitimet e krimeve njihet në rang ndërkombëtar si një nga instrumentet më efektive për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar nga themelet e tij.

Në kontekstin e përforsimit të kuadrit ligjor kombëtar, si dhe harmonizimit me legjislacionin e BE-së në këtë fushë, krijimi i Zyrës së Rikuperimit të Pasurive (ZRP) përfaqëson një hap dhe mundësi vendimtare për Shqipërinë. Krijimi i ZRP-së rregullohet me Vendimin e Këshillit të BE-së 2007/845/JHA të datës 6 dhjetor 2007²¹.

ZRP-ja do të kthehet në “zyrë me një ndalesë” për ndarjen e informacionit për rikuperimin e pasurive me vendet e treta, duke kërkuar përmirësimin e instrumenteve kombëtare (duke përfshirë aksesin në bazat e të dhënave përkatëse), bashkëpunimin e përmirësuar midis agjencive dhe shkëmbimin efektiv të informacionit ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit. Për rrjedhojë, krijimi i ZRP-së mund të shihet si një nxitës për përmirësimet në nivel kombëtar.

Treguesi do të vlerësohet duke matur ngritjen e ZRP-së (procesi) dhe funksionimin e saj (performanca).

Informacioni për vlerat bazë	Viti	2015	2016	2017
	Vlera bazë		-	-

B.3.b Zbatimi i legjislacionit për ngritjen e një Zyre të Rikuperimit të Pasurive

Informacioni për vlerat e synuara	Viti	2018	2019	2020
Vlera e synuar (procesi)		Vlerësim i kuadrit ligjor dhe identifikimi i strukturës institucionale për ngritjen e ZRP-së.	Përzgjedhja e institucionit ku do të ngrihet ZRP-ja (me vendim qeverie). Zhvillimi i ²² SoP-ve bazë.	
Vlera e synuar (performanca)				ZRP-ja është funksionale. Njoftimi i Komisionit të BE-së për ngritjen e ZRP-së

²⁰ Ky alokim është i përkohshëm. Pasi institucioni i ZRP-së të jetë përzgjedhur zyrtarisht nga Qeveria, nga ai moment ky institucion do të bëhet institucioni përgjegjës për raportimin.

²¹ <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=LEGISSUM:l14156>

²² Procedurat Standarde të Funksionimit

Objektivi B4

Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe policor ndërkombëtar në luftën kundër krimit ekonomik dhe financiar

B.4.a Numri i informacioneve të Policisë së Shtetit të zbatimit të ligjit me vendet e treta dhe institucionet mbi-kombëtare mbikëqyrëse të zbatimit të ligjit

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës Raporti Vjetor i Policisë së Shtetit Shqiptar

Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave Policia e Shtetit

Frekuenca e publikimit të të dhënave Çdo vit

Përshkrim i shkurtër i metodologjisë

Rritja e bashkëpunimit operacional me vendet e treta dhe organizatat/rrjetet mbi-kombëtare të zbatimit të ligjit (duke përfshirë, ndër të tjera, Europol, Interpol, Frontex, Egmont, CARIN, etj.). Siç u theksua në Raportin e Bashkimit Evropian të vitit 2016, “Shqipëria ka një marrëveshje operationale bashkëpunimi me Europol-n dhe që nga viti 2009 një nëpunës ndërlidhës në selinë e Europol-it. (...) Shqipëria mbetet një partner reaktiv më shumë se sa proaktiv në bashkëpunimin ndërkombëtar policor. Këto tendenca të ngjashme janë theksuar edhe në lidhje në bashkëpunimin me Interpol-in”.

Që nga viti 2017, gjurmimi i shkëmbimit të informacionit me vendet e treta dhe organizatat/rrjetet mbi-kombëtare të zbatimit të ligjit nuk është i standardizuar.

Treguesi do të vlerësohet duke matur së pari përmirësimin e procesit të monitorimit të brendshëm të Policisë së Shtetit në mënyrë që të merren të dhëna të ndara (procesi) dhe më pas rritjen e numrit total të informacionit të shkëmbyer me vendet e treta dhe institucione mbi-kombëtare (performanca).

Informacioni për vlerat bazë	Viti	2015	2016	2017
	Vlera bazë		11 ²³	51 ²⁴
Informacion për vlerat e synuara	Viti	2018	2019	2020
	Vlera e synuar (procesi)	Përditësimi i procesit të brendshëm për të marrë të dhëna të detajuara të ndara/të pandara. Publikimi i të dhënave.	-	-
	Vlera e synuar (performanca)	-	5% rritje krahasuar me bazën e 2018	5% rritje krahasuar me bazën e 2019

²³ Të dhënat e vlerësuar, duke iu referuar vetëm shkëmbimeve me Europol

²⁴ Të dhënat e vlerësuar, duke iu referuar vetëm shkëmbimeve me Europol

²⁵ Të dhënat e vlerësuar, duke iu referuar vetëm shkëmbimeve me Europol

Objektivi B4

Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe policor ndërkombëtar në luftën kundër krimit ekonomik dhe financiar

B.4.b Numri i operacioneve të përbashkëta të Policisë të nisura nga Europol ose Interpol në fushën e luftës kundër krimit financiar dhe ekonomik ku Shqipëria merr pjesë aktivisht

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës Raporti Vjetor i Policisë së Shtetit Shqiptar

Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave Policia e Shtetit

Frekuenca e publikimit të të dhënave Çdo vit

Përshkrim i shkurtër i metodologjisë Rritja e bashkëpunimit operacional me vendet e treta dhe organizatat/ rrjetet mbi-kombëtare të zbatimit të ligjit (duke përfshirë, ndër të tjera, Europol, Interpol, Frontex, Egmont, CARIN, etj.). Siç u theksua në Raportin e Bashkimit Evropian të vitit 2016, “Shqipëria ka një marrëveshje operationale bashkëpunimi me Europol-n dhe që nga viti 2009 një nëpunës ndërlidhës në selinë e Europol-it. (...) Shqipëria mbetet një partner reaktiv më shumë se sa proaktiv në bashkëpunimin ndërkombëtar policor. Këto tendenca të ngjashme janë theksuar edhe në lidhje në bashkëpunimin me Interpol-in”.

Shkëmbimi i informacionit (shih B.4.1) duhet të ndiqet nga bashkëpunimi në nivel operacional, duke përfshirë operacionet e përbashkëta të policisë.

Treguesi do të vlerësohet duke matur numrin total të operacioneve të përbashkëta të Policisë Europol dhe Interpol në fushën e luftës kundër krimit financiar dhe ekonomik ku Shqipëria merr pjesë aktivisht.

Informacioni për vlerat bazë	Viti	2015	2016	2017
	Vlera bazë		2	3
Informacioni për vlerat e synuara	Viti	2018	2019	2020
	Vlera e synuar	3	4	5

C.1.a Krijimi i planeve vjetore të komunikimit dhe vizibilitetit të Strategjisë Kundër Korrupsionit

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesve të performancës Raporti vjetor i Ministrisë së Drejtësisë/KKK

Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave Ministria e Drejtësisë/KKK

Frekuenca e publikimit të të dhënave Çdo vit

Përshkrim i shkurtër i metodologjisë

Harmonizimi i qasjes ndaj vizibilitetit dhe komunikimit në kuadrin e anti-korrupsionit është shumë e rëndësishme për të përfshirë një mesazh dhe qasje të përbashkët. Plani vjetor i vizibilitetit dhe komunikimit për Strategjinë Anti-Korrupsion do të shmangë rastet e komunikimit për çështjet anti-korrupsion në një mënyrë reaktive, të pakoordinuar mes subjekteve të ndryshme qeveritare (në nivel qendror dhe vendor).

Ky Plan do të përfshijë prioritetet që duhet të trajtohen, grupet/institucionet e synuara, mjetet e shpërndarjes, mesazhet gjatë fushatave si dhe buxhetet për zbatimin.

Shtjellimi i këtij plani do të koordinohet nga MD/KKK, duke u konsultuar me institucionet e tjera. Zbatimi i planit do të ndikojë pozitivisht në perceptimin e qytetarëve për përpjekjet për luftën kundër korrupsionit të zbatuara në Shqipëri.

Treguesi do të vlerësohet duke matur së pari hartimin e një Plani Vjetor të Vizibilitetit dhe Komunikimit (procesi) dhe më pas përdorimin e tij operacional (performanca).

Informacioni për vlerat bazë	Viti	2015	2016	2017
	Vlera bazë	-	-	-
Informacioni për vlerat e synuara	Viti	2018	2019	2020
	Vlera e synuar (procesi)	Plani i Vizibilitetit dhe Komunikimit për vitin 2018 finalizohet në Q2	Plani i Vizibilitetit dhe Komunikimit për vitin 2019 finalizohet dhe publikohet në Q1	Plani i Vizibilitetit dhe Komunikimit për vitin 2020 finalizohet dhe publikohet në Q1
	Vlera e synuar (performanca)	-	Buxheti specifik i alokuar për zbatimin e Planit të Vizibilitetit dhe Komunikimit	Është vendosur në zbatim 50% e detyrave të ndërgjegjësimit dhe komunikimit të parashikuara në Planin e Vizibilitetit dhe Komunikimit.

C.1.b Numri i fushatave vjetore të ndërgjegjësimit për luftën kundër korrupsionit

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesve të performancës	Raporti vjetor i Ministrisë së Drejtësisë/KKK
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Ministria e Drejtësisë/KKK
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Çdo vit
Përshkrim i shkurtër i metodologjisë	<p>Fushatat e komunikimit dhe ndërgjegjësimit në fushën e luftës kundër korrupsionit janë një instrument i rëndësishëm për të komunikuar përpjekjet kundër korrupsionit të zbatuara në vend, duke rritur partneritetin efektiv midis qytetarëve dhe institucioneve.</p> <p>Këto fushata do të zbatohen në përputhje me Planin Vjetor të Vizibilitetit dhe Komunikimit të Strategjisë Anti-Korrupsion (referojuni C.1.a). Temat e fushatave do të pasqyrojnë prioritetet aktuale që do të trajtohen brenda një viti.</p> <p>Performanca do të vlerësohet duke matur numrin total të fushatave të ndërgjegjësimit të zbatuara në Shqipëri për të luftuar korrupsionin, në përputhje me Planin Vjetor të Vizibilitetit dhe Komunikimit të Strategjisë Anti-Korrupsion.</p>

Informacioni për vlerat bazë	Viti	2015	2016	2017
	Vlera bazë		-	-

Informacioni për vlerat e synuara	Viti	2018	2019	2020
	Vlera e synuar		4	4

²⁶ Përlllogaritja e vlerës bazë nuk është e mundur pasi fushatat e zhvilluara për ndërgjegjësimin dhe vizibilitetin nuk janë ndjekur në mënyrë të konsoliduar.

Objektivi C2

Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat në denoncimin dhe parandalimin e korrupsionit

C.2.a Numri i denoncimeve të qytetarëve për korrupsion të denoncuar në platformën www.shqiperiaqeduam.al

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesve të performancës	Raporti vjetor								
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje								
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Çdo vit (raportim i posaçëm i disponueshëm çdo muaj por konsolidimi i të dhënave kryhet çdo vit)								
Përshkrim i shkurtër i metodologjisë	<p>Platforma e re www.shqiperiaqeduam.al, nga tetori i vitit 2017, krijoi një “zyrë me një ndalesë” për të gjitha ankesat dhe propozimet e qytetarëve. Portali www.stopkorrupsionit.al është mbyllur dhe funksionet e tij janë integruar në platformën www.shqiperiaqeduam.al.</p> <p>Në mënyrë specifike për denoncimin që lidhen me korrupsionin, platforma e re kërkon që qytetarët të identifikohen kur kryejnë denoncime. Ky funksionalitet i ri ndikon pozitivisht në kapacitetin e zbatimit të ligjit për të ndjekur hetimet bazuar në denoncimet e qytetarëve përmes kësaj platforme.</p> <p>Denoncimet e korrupsionit do të gjurmohen nga portali, veçmas nga të gjitha ankesat e tjera.</p> <p>Ky tregues do të vlerësohet duke matur numrin total të denoncimeve të qytetarëve për rastet korruptive të denoncuar në platformën e re www.shqiperiaqeduam.al.</p>								
Informacioni për vlerat bazë	<table border="1"><thead><tr><th>Viti</th><th>2015</th><th>2016</th><th>2017</th></tr></thead><tbody><tr><td>Vlera bazë</td><td>-</td><td>-</td><td>²⁷</td></tr></tbody></table>	Viti	2015	2016	2017	Vlera bazë	-	-	²⁷
Viti	2015	2016	2017						
Vlera bazë	-	-	²⁷						
Informacioni për vlerat e synuara	<table border="1"><thead><tr><th>Viti</th><th>2018</th><th>2019</th><th>2020</th></tr></thead><tbody><tr><td>Vlera e synuar</td><td>25 % rritje krahasuar me vitin e mëparshëm</td><td>30% rritje krahasuar me vitin e mëparshëm</td><td>40% rritje krahasuar me vitin e mëparshëm</td></tr></tbody></table>	Viti	2018	2019	2020	Vlera e synuar	25 % rritje krahasuar me vitin e mëparshëm	30% rritje krahasuar me vitin e mëparshëm	40% rritje krahasuar me vitin e mëparshëm
Viti	2018	2019	2020						
Vlera e synuar	25 % rritje krahasuar me vitin e mëparshëm	30% rritje krahasuar me vitin e mëparshëm	40% rritje krahasuar me vitin e mëparshëm						

²⁷ E padisponueshme – portali u ndërtua në fund të vitit 2017

Objektivi C2

Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat në denoncimin dhe parandalimin e korrupsionit

C.2.b Numri i rasteve të korrupsionit të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve në www.shqiperiaqeduam.al, të cilat i raportohen Policisë së Shtetit/Prokurorisë Shqiptare

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesve të performancës	Raporti vjetor
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Çdo vit (raportim i posaçëm i disponueshëm çdo muaj por konsolidimi i të dhënave kryhet çdo vit)
Përshkrim i shkurtër i metodologjisë	<p>Portali i ri shqiperiaqeduam.al, nga tetori i vitit 2017, krijoi një “zyrë me një ndalesë” për të gjitha ankesat dhe propozimet e qytetarëve. Portali stopkorrupsionit.al është mbyllur dhe funksionet e tij janë integruar në portalin shqiperiaqeduam.al.</p> <p>Në mënyrë specifike për denoncimin që lidhen me korrupsionin, portali i ri kërkon që qytetarët të identifikohen kur kryejnë denoncime. Ky funksionalitet i ri ndikon pozitivisht në kapacitetin e zbatimit të ligjit për të ndjekur hetimet bazuar në denoncimet e qytetarëve përmes këtij portali.</p> <p>Denoncimet e korrupsionit do të gjurmohen nga portali, veçmas nga të gjitha ankesat e tjera. Ato u dërgohen institucioneve përgjegjëse ku kryhet një kontroll i brendshëm/inspektim i nivelit të parë, ndonjëherë në bashkëpunim të ngushtë me Njësinë Anti-Korrupsion në Kryeministri. Rastet që konfirmohen të jenë të lidhura me praktikat korruptive më pas referohen në Polici/ Prokurori për hetime të mëtejshme.</p> <p>Treguesi do të vlerësohet duke matur numrin total të rasteve të korrupsionit të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve në www.shqiperiaqeduam.al, të cilat raportohen nga institucionet e linjës²⁸ tek Policia/Prokuroria Shqiptare</p>

Informacioni për vlerat bazë	Viti	2015	2016	2017
	Vlera bazë	-	-	- ²⁹
Informacioni për vlerat e synuara	Viti	2018	2019	2020
	Vlera e synuar	25 % rritje krahasuar me vitin e mëparshëm	30% rritje krahasuar me vitin e mëparshëm	40% rritje krahasuar me vitin e mëparshëm

²⁸ Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje duhet të ndjekë rastet e korrupsionit të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve në www.shqiperiaqeduam.al, derisa këto raste të pushohen ose zgjidhen administrativisht nga institucionet e linjës ose të përcillen në Policinë e Shtetit Shqiptar.

²⁹ E padisponueshme – portali u ndërtua në fund të vitit 2017

C.3.a Hartimi i një Programi Anti-korrupsion nga AMSHC-ja

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Raporti vjetor i AMSHC-së
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC)
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Çdo vit
Përshkrim i shkurtër i metodologjisë	<p>Ndër objektivat kryesore strategjike të AMSHC-së, siç është paraqitur me deklaratën e Misionit dhe Objektivat, është promovimi i bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile që fokusohen në anti-korrupsion.</p> <p>Aktualisht, Agjencia nuk ka një Program të specializuar për anti-korrupsionin, që të koordinohet nga një departament i saj. Hartimi i një programi të tillë do të kontribuonte pozitivisht në bashkëpunimin afatgjatë me OSHC-të, duke rritur parashikueshmërinë, angazhimin, qëndrueshmërinë dhe efektivitetin. Programi duhet të përfshijë aktivitetet ekzistuese në fushën e anti-korrupsionit, duke krijuar sinergji dhe efekt shumëfishues.</p> <p>Treguesi do të vlerësohet duke matur së pari krijimin e një Programi të Brendshëm për Anti-korrupsionin (procesi) dhe më pas vendosjen e tij në funksionim (performanca).</p>

Informacioni për vlerat bazë	Viti	2015	2016	2017
	Vlera bazë		-	-
Informacioni për vlerat e synuara	Viti	2018	2019	2020
	Vlera e synuar (procesi)	Hartimi i një programi Anti-Korrupsion) duke përfshirë Planin e Veprimit 2019-2020)	-	-
	Vlera e synuar (performanca)	-	Hartimi dhe publikimi i Raportit vjetor të zbatimit të Programit Anti-Korrupsion (si një pjesë specifike e raportit vjetor të Agjencisë)	Është përfunduar vlerësimi i jashtëm mbi zbatimin vjetor të Programit Anti-Korrupsion të vitit 2019

C.3.b Raporti i projekteve të anti-korrupsionit të financuar nga ASCS

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesve të performancës	Raporti vjetor i AMSHC-së
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC)
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Çdo vit

Përshkrim i shkurtër i metodologjisë Ndër objektivat kryesore strategjike të AMSHC-së, siç është paraqitur me deklaratën e Misionit dhe Objektivat, është promovimi i bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile që fokusohen në anti-korrupsion.

Numri i Thirrjeve për Propozim të lëshuara dhe masat e financuara në fushën kundër korrupsionit përfaqësojnë një tregues të rëndësishëm të performancës. Analiza e të këtyre dhënave do të kryhet duke u kombinuar me Treguesin C.3.a (me Thirrjet për Propozime që janë pjesë e programit Anti-Korrupsion nga viti 2019) dhe C.3.c (alokimi i buxhetit).

Performanca do të vlerësohet duke matur raportin e projekteve të financuara në fushën e anti-korrupsionit, mbi numrin total të projekteve të financuara nga AMSHC. Formula specifike e përdorur për vlerësimin do të jetë:

$$AC_{Proj} = \frac{\sum \text{e numrit të projekteve të AK të financuara nga AMSHC}}{\sum \text{e numrit të projekteve të financuara nga AMSHC}} \times 100\%$$

Informacioni për vlerat bazë	Viti	2015	2016	2017
	Vlera bazë		16.67%	24.39%
Vlera e synuar	Viti	2018	2019	2020
	Vlera e synuar	20%	25%	25%

C.3.c Alokimi i buxhetit në mbështetje të Projekteve të Anti-korrupsionit nga OSHC-të

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës Raporti vjetor i AMSHC-së

Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC)

Frekuenca e publikimit të të dhënave Çdo vit

Përshkrim i shkurtër i metodologjisë Ndër objektivat kryesore strategjike të AMSHC-së, siç është paraqitur me deklaratën e Misionit dhe Objektivat, është promovimi i bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile që fokusohen në anti-korrupsion. Buxheti i përcaktuar, nëpërmjet Thirrjeve për Propozim të lëshuara dhe projekteve të dhëna në fushën kundër korrupsionit përfaqësojnë një tregues të rëndësishëm të performancës. Analizimi i të dhënave të tilla do të kryhet bashkë me Treguesin C.3.b (numri i projekteve)

Performanca do të vlerësohet duke matur raportin e buxhetit të përcaktuar për projektet që synojnë të luftojnë korrupsionin, mbi buxhetin total të përcaktuar për projektet e AMSHC-së. Formula specifike e përdorur për vlerësimin do të jetë:

$$AC_{\text{Proj-budget}} = \frac{\sum \text{e buxhetit të projekteve të AK të financuara nga AMSHC}}{\text{buxheti total i projekteve të AK të financuara nga AMSHC}} \times 100\%$$

Informacioni për vlerat bazë	Viti	2015	2016	2017
	Vlera bazë		8.95%	23.71%
Vlera e synuar	Viti	2018	2019	2020
	Vlera e synuar	20%	25%	25%

Pasaporta e treguesve dhe vlerësimi bazë janë rezultat i projektit të financuar nga BE-ja “Studimi Bazë i Matjes - Kontrata e Reformës Sektoriale për Luftën kundër Korrupsionit”, e realizuar nga një ekip ekspertësh e përbërë nga Z. Andrea D’Angelo, Z. Arjan Dyrmishi dhe Z. John Heck, dhe e kontraktuar nga A.R.S. Progetti S.P.A. Projekti u zbatua përgjatë periudhës tetor 2017 - prill 2018.



This project is funded
by the European Union

Disclaimer:

This report has been prepared with the financial assistance of the European Commission. The views expressed herein are those of the consultants and therefore in no way reflect the official opinion of the Commission.